

BANKA E SHQIPËRISË

**TREGU I KËMBIMIT VALUTOR
NË SHQIPËRI NË VITIN 2000**

Përmbledhje e analizës së vrojtimit

Teuta Baleta
Dr. Evelina Çeliku

QERSHOR 2001

Publikuar nga Banka e Shqipërisë, Sheshi “Skënderbej”, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: 355- 4- 222152; 222153; 222156;
Faks: 355-4-223558

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me Zj. Adriana Meko,
Zyra e Botimeve, Departamenti i Kërkimeve
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë
Tirazhi : 800 kopje

HYRJE

Tregu valutor në Shqipëri përbëhet nga dy elemente: tregu zyrtar dhe tregu jozyrtar. Në tregun zyrtar përfshihen operatorët e licencuar për të ushtruar veprimtari valutore. Autoriteti licencues i këtyre operatorëve është Banka e Shqipërisë. Aktualisht në tregun zyrtar valutor veprojnë 13 banka dhe 21 zyra këmbimi valutor në të gjithë territorin e vendit, si edhe vetë Banka e Shqipërisë.

Në tregun jozyrtar përfshihen një grup individësh të cilët kryejnë këmbime valutore dhe që janë të palicencuar. Si të tillë ata nuk i nënshtrohen zbatimit të asnjë rregulli që ka miratuar Banka e Shqipërisë për tregun valutor si edhe nuk raportojnë. Në gjuhën e përditshme këta individë quhen “kambistë të lirë”. Ata veprojnë në mënyrë të dukshme që prej fillimit të viteve '90 dhe përgjithësisht janë të vendosur në qendër të Tiranës, pranë godinës së Bankës së Shqipërisë. Midis këtyre dy tregjeve ose dy grupeve të operatorëve qëndrojnë bizneset dhe individët të cilët këmbajnë monedhat për nevoja të përditshme, për nevoja investimi apo kursimi. Shkalla e përdorimit të dy përbërësve të tregut valutor është e ndryshme.

Përdorimi i valutave në Shqipëri është i lirshëm, pasi me ligj ato mund të përdoren si mjet pagese dhe çdo transaksion i kryer apo kontratë e nënshkruar që përcakton çmim në valutë ka vlefshmëri. Kjo do të thotë që është e lejueshme të bësh pagesa apo të pranosh arkëtime në monedha të huaja, të nënshkruash kontratë në monedhë të huaj, të depozitosh në monedhë të huaj apo të këmbesh monedhën e vendit me valuta të ndryshme pa kufizim. Regjimi valutor që zbatohet në Shqipëri është ai i kursit të lirë luhatës. Banka e Shqipërisë vepron në tregun valutor vetëm për të zbutur lëvizjet spekulative të kursit. Në këtë hapësirë “lirie” përgjithësisht është vërejtur që Leku shqiptar luhatet midis dollarit amerikan dhe monedhave europiane.


Për të kuptuar orientimin e operatorëve si dhe klientëve të tregut valutor në lidhje me monedhat që përdorin më tepër, konsideratat për monedhën më të fortë apo monedhën më të përshtatshme për të kursyer, investuar apo për ta pasur si pikë orientimi në vendimmarrje u organizua një vrojtimit statistikor. Vrojtimi përfshiu të gjitha bankat (13), të gjitha zyrat e këmbimit valutor (21), kambistë të tregut jozyrtar (50), biznese të klasifikuar si më të mëdha dhe të mëdha (150) dhe individë (100). Qëllimi kryesor i vrojtimit ishte gjetja e përgjigjeve për pyetjet e mëposhtme: Cilin kurs këmbimi duhet të ndjekim më ngushtësisht, lek/usd apo lek/euro? A janë të dyja këto monedha të rëndësishme dhe në ç'raporte? Cila është monedha e huaj që përdoret më tepër për kursimet? Cila është monedha e huaj që orienton vendimmarrjen?

Megjithatë, rezultatet e vrojtimit sjellin informacione të tjera, të cilat mund të jenë mjaft interesante e të vlefshme.

Tregu i këmbimit valutor në Shqipëri në vitin 2000.

GJEOGRAFIA E TRANSAKSIONEVE

Bankat, zyrat e këmbimit (në material i referohemi si zyra) dhe bizneset kanë dhënë opinionin e tyre mbi shpeshtësinë e kryerjes së transaksioneve valutore me shtete të tjera. Del në pah se peshën kryesore në transaksionet e kryera nga këto grupe e zë Italia dhe Greqia, ndërsa e treta renditet Gjermania. Për të tre këto shtete së bashku përgjigjen 80.5 për qind e të intervistuarve. Struktura e shteteve me të cilat kryhen transaksione përputhet me modelin e partnerëve kryesorë tregtarë të Shqipërisë. Marrëdhëniet tregtare me Italinë, Greqinë dhe Gjermaninë përbëjnë rreth 74 për qind të volumit gjithsej të tregtisë së jashtme të Shqipërisë.



Italia është shteti me të cilin kryhen më shumë transaksione valutore.




Struktura e shteteve me të cilat kryhen transaksione përputhet me modelin e partnerëve kryesorë tregtarë të Shqipërisë.

Ndërsa gjeografia e transaksioneve tenton drejt Italisë dhe Greqisë, monedha më e preferuar është dollari amerikan.

MONEDHA MË E PREFERUAR NË PËRDORIM


Bankat, zyrat, kambistët dhe bizneset kanë dhënë preferencat e tyre për përdorimin e monedhave të huaja shpeshtësinë e kryerjes së transaksioneve valutore me shtete të tjera. Del në pah se më tepër preferohet dollari amerikan (67.8 për qind), dhe më pak lireta italiane (33 për qind) dhe dhrahmia greke (24.8 për qind). Krahasuar me mesataren e përdorimit të nënfishave të euros, rezulton se dollari amerikan ka një shpeshtësi preference rreth 2.7 herë më të lartë se çdonjeri prej tyre mesatarisht.



MONEDHA MË E FORTË MONEDHA ORIENTUESE NË PROCESIN E VENDIMMARRËS


Bankat, zyrat, kambistët dhe bizneset kanë dhënë opinione edhe mbi perceptimin e tyre për monedhën më të fortë dhe për monedhën që i orienton ata në vendimmarrje. Dollari amerikan evidentohet si monedha më e fortë (86.2 për qind). Si i tillë ai kap vlera shumë të larta dhe mjaft të distancuara nga monedhat e tjera.

Dollari amerikan konsiderohet si monedha më e fortë.



Dollari amerikan konsiderohet si monedha që orienton vendimarrjen nga 70.6 për qind të të intervistuarve. Nënfishat e euro-s së bashku konsiderohen si orientuese vetëm nga 32.1 për qind e të intervistuarve.

Dollari amerikan evidentohet si monedha kryesore e cila orienton procesin vendimmarrës (70.6 për qind). Relativisht të konsiderueshme në vendimarrje janë edhe nënfishat e euro-s. Madje vërehet që megjithëse këto nënfisha nuk perceptohen shumë të forta, luajnë një rol më të madh në aspektin e orientimit, ndonëse edhe në këtë pikë, ato qëndrojnë ende larg dollarit amerikan.




MONEDHA MË E PREFERUAR

Bankat, zyrat, kambistët, bizneset dhe qytetarët kanë dhënë opinionin e tyre për preferencat ndaj monedhave të huaja dhe evolucionin e kësaj preference për vitet 1999 dhe 2000.

Në tërësinë e të intervistuarve, preferenca për monedhën amerikane është shumë më e lartë se për monedhat e tjera. Ky është një fakt që spikat dukshëm për të dy vitet, përkatësisht 63.5 dhe 66.3 për qind. Madje, preferenca në vitin 2000 për dollarin amerikan është përforcuar me 2.8 pikë përqindjeje.

Nënfishat e euro-s së bashku preferohen nga 43.6 për qind dhe 41.4 për qind përkatësisht për vitet 1999 dhe 2000, pra është reduktuar. Ky konkluzion i vrojtimit përputhet edhe me realitetin e ecurisë së valutave në tregun valutor. Kështu, periudha 1999-2000 është karakterizuar nga një nënçmim i euros, gjë që ka shkaktuar edhe orientimin e preferencave drejt monedhës amerikane.

Dollari amerikan është monedha më e preferuar si në vitin 1999 ashtu edhe në vitin 2000. Preferenca për të ka ardhur duke u forcuar.



Tregu jozyrtar është më i preferuari për të këmbyer monedhat. Preferenca për tregun jozyrtar krahasuar me atë zyrtar (bankat dhe zyrat së bashku), qëndron rreth 6 pikë përqindjeje më lart.

OPERATORI MË I PREFERUAR PËR KËMBIME VALUTORE

Bankat, zyrat, kambistët, bizneset dhe qytetarët kanë dhënë opinionin e tyre për preferencat ndaj operatorëve të këmbimeve valutore. Në përgjithësi vërehet një shpërndarje relativisht uniforme e preferencave gjë që flet për një përdorim të gjerë dhe në nivele të krahasueshme të të gjithë operatorëve. Megjithatë, operatori më i preferuar është tregu jozyrtar duke zënë 38.7 përqind të preferencave në total. Vend të konsiderueshëm zë edhe kombinimi i operatorëve. Shpesh në rastet kur elementet e kombinimit janë specifikuar qartë, ka dalë se njëri prej operatorëve të kombinuar është tregu jozyrtar. Në total vlerësohet se ky i fundit është akoma më i preferuar, se operatorët e tjerë.

Tabela 1. Preferenca për operatorët e këmbimeve valutore.

Operatorët	Në %
1. Kambistët (tregu jozyrtar)	38.7
2. Kombinim operatorësh	28.5
3. Bankat	21.5
4. Zyrat e këmbimit valutor	11.3


KARAKTERISTIKAT E TREGUT JOZYRTAR

Analiza e vrojtimit dhe arsyetimet e paraqitura nxjerr në pah tre tipare dalluese (më të spikatura) të tregut jozyrtar:

- 1. Kosto e ulët.** Kryerja e transaksioneve në këtë treg ka një kosto më të ulët për shkak të kurseve më të favorshme që ofron në krahasim me operatorët zyrtarë.
- 2. Shpejtësi më lartë veprimi.** Veprimi i këmbimit kryhet menjëherë gjë që kursen kohën duke reduktuar më tepër koston e transaksionit.
- 3. Likuiditet më i lartë.** Tregu jozyrtar është mjaft likuid dhe në çdo kohë mund të këmbesh çdo lloj shume (shuma të mëdha apo të vogla) dhe në çdo lloj monedhe. Tregu jozyrtar të ofron mundësinë e këmbimit edhe për monedha të konsiderueara si të rralla.

Këto tre tipare rrisin eficiencën e këtij tregu e bëjnë atë mjaft konkurrues. Për këto arsye operatori më i preferuar janë kambistët. Po për këto arsye rreth 67 për qind e bankave, zyrave, kambistëve dhe bizneseve shprehen se ky treg është i nevojshëm.

Tregu jozyrtar është mjaft konkurrues. Ai ofron kosto të ulët dhe shpejtësi shërbimi si dhe likuiditet të lartë.



Përafërsisht vlerësohet se në tregun jozyrtar vëllimi total i transaksioneve arrin në 2.4 miliardë dollarë në vit.

Madhësia e tregut jozyrtar, vlerësuar sipas deklarimeve të kambistëve, pra vetë operatorëve të këtij tregu, gjykohet e konsiderueshme. Në një vit në këtë treg kryhen mesatarisht transaksione mesatar 2.4 miliardë dollarë amerikanë.

Madhësia e këtij tregu dhe karakteristikat e funksionimit të tij e bëjnë atë mjaft konkurrues dhe të leverdisshëm. Në këtë kuadër, rekomandohet që reduktimi i tregut jozyrtar valutor të bëhet gradualisht dhe me mjaft kujdes. Është e nevojshme që nga njëra anë të ushtrohet presion për të rritur konkurrencën e operatorëve zyrtarë dhe nga ana tjetër të reduktohet leverdia e tregut jozyrtar.

POLITIKA VALUTORE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë të ligjit të bankës qendrore, Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për deklarimin e regjimit të kursit të këmbimit në vend dhe hartimin e politikës valutore. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë miraton dhe rregullat për tregun e këmbimeve valutore, licencon operatorët e këtij tregu si dhe vepron me shitje apo blerje valute. Të gjitha këto veprime të Bankës së Shqipërisë, në përgjithësi vlerësohen pozitivisht.

Bankat, zyrat, kam bistët dhe bizneset shprehën:

- ? pro regjimit të kursit të lirë të këmbimit në 39.4 për qind të rasteve (pa opinion 37.5 për qind);
- ? se veprimet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor bëhen në momentet e përshtatshme, në 32.1 për qind të rasteve (pa opinion 44 për qind);
- ? se me veprimet e saj, Banka e Shqipërisë realizon qëllimin e saj, në 39.6 për qind të rasteve (pa opinion 46.1 për qind);
- ? se Banka e Shqipërisë duhet të veprojë në treg për të ruajtur një kurs stabil të këmbimit, në 76.1 për qind të rasteve;
- ? se dollari amerikan paraqitet si monedha më e përshtatshme për shit-blerje nga ana e Bankës së Shqipërisë në treg, në 85.8 për qind të rasteve.

Tabela 2: Shpërndarja e përgjigjeve sipas monedhës/ave më të përshtatshme për të kryer shit-blerjet valutore.

Monedha	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	85.8
Lireta italiane	3.7
Marka gjermane	9.6
Dhrahmia greke	4.1

Në përgjithësi, politika e ndjekur nga Banka e Shqipërisë në lidhje me tregun valutor vlerësohet pozitivisht.



Banka e Shqipërisë duhet të jetë më transparente në lidhje me politikën dhe veprimtarinë valutore.

Megjithatë, në këto pyetje vlerësuese për politikën e Bankës së Shqipërisë dhe veprimtarinë e saj në tregun valutor është i lartë dhe niveli i mosdhënies së opinioneve. Rekomandohet që Banka e Shqipërisë të rrisë shkallën e transparencës dhe sidomos të edukimit të publikut me çështjet e tregut valutor.

ECURIA E EURO-S

Duke krahasuar vitin 2000 me vitin 1999 në lidhje me peshën që zë euro në veprimtarinë valutore bankat, zyrat, kambistët dhe bizneset përgjigjen se monedha europiane nuk ka fuqizuar pozicionin e saj, në 65.6 për qind të rasteve.

Tabela 3: Ecuria e rëndësisë së euros.

Monedha	Përgjigjet (në %)*
Nuk Është rritur	65.6
Është rritur	15.1
Nuk ka ndryshuar	4.1
Pa opinion	15.1

Në përgjithësi rëndësia e monedhës europiane në tërësinë e transaksionet valutore nuk ka pësuar rritje të dukshme në vitin 2000 krahasuar me vitin 1999.

Në Shqipëri, ndër monedhat e huaja, më e preferuara në përdorim dhe që njëkohësisht gëzon qëndrueshmëri dhe aftësi orientuese në vendimarrje, evidentohet dukshëm të jetë dollari amerikan. Kjo monedhë vlerësohet si më e përshtatshme për të vepruar në treg Banka e Shqipërisë.

Tregu i këmbimit valutor në Shqipëri në vitin 2000.